

## Emri i Lëndës : Problematikat Themelore të Filozofisë së Fesë

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 431	A	-1	3	0	0	3.00	6
<b>Lektori dhe orari i konsultimeve</b>			Genti Kruja, PhD				
<b>Asistenti dhe orari i konsultimeve</b>			Ledian Cikalleshi, Msc				
<b>Gjuha e kursit</b>							
<b>Niveli i lëndës</b>							
<b>Përshkrimi</b>			Kjo lëndë duke analizuar temat bazë të filozofisë së fesë si “marrëdhënia intelekt-shpallje hyjnore”, “argumente mbi ekzistencën e Zotit”, “eksperienca fetare”, “gjuha fetare dhe atributet e Zotit”, “marrëdhënia femoral”, “problemi i të keqes”, “jeta pas vdekjes”, “feja dhe pluralizmi fetar”, arrin t’i përftojë studentit aftësinë e të menduarit në mënyrë më racionale, më kritikuese dhe më të përgjithshme.				
<b>Objektivat</b>			Të pajisim studentët me aftësinë për të bërë interpretime rreth termave themelore dhe argumenteve të filozofisë së fesë.				

## Programi i Lëndës

Java	Tema
<b>1</b>	Çfarë është filozofia e fesë? Relata fe-filozofi. C’është filozofia? C’është feja? Filozofia e Fese: Perkufizimi i termi “filozofia e fese”; A është i përhapur termi “filozofia e fese”? Cilat janë problematikat themelore të filozofisë së fese dhe çfare trajtojnë? 1. Problemet metafizike: Ekzistenca apo mosekzistenca e zotit, argumentet pro dhe kundër ekzistencës, revelata (shpallja), vlera ekzistenciale e njeriut etj. 2. Problemet epistemologjike: Ashtu si nisesh nga pasoja për të arritur të shkaku, vlera shkencore kur nisesh nga dija të zoti, revelata (shpallja), inspirimi dhe frymëzimi si dhe eksperienca fetare. 3. Analiza gjuhësore dhe logjike e dispozitave fetare: Lidhja mes postulateve morale dhe postulateve shkencore, analogjite që përdorim për të kuptuar zotin; Simbolizmat fetare dhe botëkuptimi i tyre; A kanë vlerë shkencore dhe sa ato reflektojnë të vërtetën? Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 42-74
<b>2</b>	Argumentet rreth ekzistencës së Zotit: Argumenti Ontologjik Argumenti i Anselmit u quajt argumenti ontologjik, argument ky që ka shkaktuar ndarje të thellë mes filozofëve që prej asaj kohe. Shume filozofë të shquar të shekullit të 20të, si Çarls Hartshorn, Norman Malkolm dhe Alvin Plantinga, mendojnë se ky është një argument i shëndoshë. Një përmbledhje e Argumentit Ontologjik: 1. Ekziston mundësia që një Qenie Maksimalisht e Madhe të ekzistojë.; 2. Një Qenie Maksimalisht e Madhe ekziston në ndonjë botë të mundshme.; 3. Nëse një Qenie Maksimalisht e Madhe ekziston në ndonjë botë të mundshme, atëherë ajo ekziston në çdo botë të mundshme.; 4. Nëse një Qenie Maksimalisht e Madhe ekziston në çdo botë të mundshme, atëherë ajo ekziston edhe në botën reale.; 5. Një Qenie Maksimalisht e Madhe ekziston në botën reale.; 6. Për pasojë, një Qenie Maksimalisht e Madhe ekziston.; Kritikkat e argumentit Ontologjik Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq.111-124
<b>3</b>	Argumentet rreth ekzistencës së Zotit: Argumenti Kozmologjik Argumenti kozmologjik është një argument i bazuar në parimin se çdo gjë ka një shkak. Argumenti Kozmologjik është familje e argumenteve, të cilat nisen nga universi, për të shkuar të shkaku i shkaqeve që është Zoti.; 1. Argumenti i krijimit (Hudus): Cdo gjë e krijuar ka një krijues; Bota/universi është i krijuar; Keshtu që edhe bota/universi ka një krijues; Dhe ai krijues është Zoti/Allahu.; 2. Argumenti i mundësisë (Imkan): Cdo gjë e munduar ka një gjë të detyrueshme që e ka mundësuar; Bota/universi është e mundur; Keshtu që edhe bota/universi ka një gjë të detyrueshme që e ka mundësuar; Dhe ai krijues është Zoti/Allahu.; 3. Argumenti i levizjes (Hareket): Cdo gjë që leviz e ka një levizës; Bota/universi është në levizje; Keshtu që edhe bota/universi ka një levizës; Dhe ai levizës është Zoti/Allahu.; Kritikkat e argumentit Kozmologjik Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 125-132
<b>4</b>	Argumentet rreth ekzistencës së Zotit: Argumenti i Përvojës Fetare Argumenti i përvojës/eksperiences fetare ose thënë ndryshe argumenti mistik është përdorur për herë të parë nga filozofi William James në shek. e 19, kur shkroi librin “Llojet e eksperiences fetare”. Është një argument i lindur për shkak të shkencës pozitiviste. Domethënë nëse dikë është provuar me metoda eksperimentale tregon se është e vërtetë. Nuk është i saktë si argument, pasi termi eksperience është term teknik. Karakteristikat e experiences fetare: 1- Ndryshojnë në varesi të kultures; 2. Ndodh menjëherë; 3. Është e pamundur të shpjegohet me fjale; 4. Kjo eksperience është unifikuar, nuk ka një proces.; Kritikkat e argumentit të experiences fetare Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 158-168

5	Argumentet rreth ekzistencës së Zotit: Argumenti Teleologjik Argumenti i rregullsisë (Nizam ve gaye delili): Me anë të këtij argumenti, duke parë rregullin e pashmangshëm dhe harmoninë e madhe që mund të përceptohen dhe njihen me anë të shqisave në natyrë dhe në dukuritë që ndodhin në të, pohohet se kjo harmoni në gjithësi është vepër e një krijuesi që di gjithçka dhe që ka fuqi për gjithçka. Ky argument quhet ndryshe edhe argument i qëllimit final, i urtësisë, i sigurisë, i favorit.; Kritikat e argumentit Teleologjik Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 133-157
6	Teizmi dhe atributet e Zotit Disa Terma Filozofike (Teizmi, Deizmi, Panteizmi, Gnosticizmi, Ateizmi) dhe qasjet ne filozofine e fese; Atributet e Allahut janë trajtuar, përgjithësisht, në dy grupe: attribute individuale dhe attribute qenësore. 1. Atributet Individuale (Dhatí): Ekzistencë (vuxhud), Paraqenie (kidem), Pasqenie (beka), Pangjashmëri me qeniet e krijuara (muhalefetun li'l-hauadith), Njësi (vahdanijet), Ekzistencë në vetvete (kijam bi nefsihi). 2. Atributet Qenësore (Thubutí): Jetë (hajat), Dituri (ilm), Dëgjim (sem'), Shikim (basar), Vullnet (irade), Fuqi (kudret), Fjalë (kelam), Krijim (tekvin); Te flasësh për atributet e Zotit, është me e veshtire se sa te flasësh për vete Zotin, sepse: 1. Disa attribute që pranon filozofia, nuk i pranon feja dhe disa attribute të pranuar nga feja nuk i pranon filozofia. 2. Te flasësh për atributet e Zotit, detyrimisht do të flasësh për universin dhe njeriun. Kur flet për atributin e krijimit, për krijimet e Zotit është e pamundur të mos përmendësh universin dhe njeriun. Kur trajtohet çështja e te qenurit të Zotit me vullnet absolut, do të shfaqen probleme si vlera dhe çështja e vullnetit të njeriut, problemi i se keqes etj. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 103-110
7	Analizat gjuhësore dhe gjuha e fesë Duke qene se propozicionet fetare dhe metafizike, nuk mundën të mendohen si pohimet shkencore, kjo nxorri ne pah problemin e te menduarit ne nje menyre tjetere te tyre. Nje pjese e mire e analisteve gjuhesore, nxiten nga mendimi se te qenurit e kuptimte e dickaje dhe te qenurit e verifikueshme, nuk jane sinonime. Nje vertetim i bere sipas parimit te verifikimit, nuk eshte forma e vetme e vertetimit. Filozofia e gjuhës është një nga rrymat më interesante të lindura në filozofinë moderne dhe një nga përfaqësuesit e saj të mëdhenj është Ludwig Wittgenstein. Aplikimi i kesaj metode te gjuha fetare, solli nje lehtesim per fene. Kjo qasje, duke qene se e trajton nje pohim fetar ne perberjen gjuhesore. Kjo qasje, duke qene se e trajton nje shprehje fetare brenda perberjes gjuhesore parandalon nje pjese te rreziqeve qe nxjerrin qasjet reduksjoniste dhe abstraktive. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 90-102
8	Provim Gjysmëfinal
9	Problemi i së keqes Termi 'teodise', i formuar nga fjalët Greke 'theos' - Zot, dhe 'dike' - drejtësi, "është përdorur për herë të parë nga filozofi Gjerman Gotfrid Lajbnic në veprën e tij 'Essais de Theodicée'. Ky term tregon përpjekjen për të provuar se drejtësia hyjnore qëndron e paprekur nga ekzistenca e së keqes. Si problem, sic thame me lart, është hedhur për herë të parë si pyetje nga Epikuri, i cili thoshte: "Nese thoni se zoti/erat ka/ne qellim te mire, atehere perse ekziston e keqja ne bote?". Te keqijate: 1- Fizike/Natyrore: Te keqijate te cilat dalin si rezultat e shkaqeve natyrore si termetet, permbytjet, shiu meteoreve, zjarret emertohen "Te keqija fizike ose natyrore"; 2- Morale: Te keqijate te cilat vijne per shkaqe njerezore ose nga njeriu quhen "Te keqija morale". Keto ne pergjithsi permbajne padrejtesi, ngrenie te hakut, shkaktojne dhimbje dhe pasqyrojne vetite negative te karakterit. Psh. vrasjet, perdhunimet dhe padrejtesite e tjera si keto.; 3- Metafizike: Te keqijate te cilat dalin si rezultat i te qenurit te botes jo perfekte, njeriu i vdekshem dhe i kufizuar emertohen "Te keqija metafizike", pra qe nuk varen as nga njeriu dhe as nga natyra. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 169-181
10	Feja dhe shkenca Nga diskutimet per kete ceshtje kane dale disa teza: 1- Feja dhe shkenca perplasen me njera-tjetren; 2- Feja dhe shkenca jane te ndara nga njera-tjetra; 3- Feja dhe shkenca perputhen me njera-tjetren. Asnje shpjegim shkencor, nuk eshte shpikur per te vertetuar ose pergenjeshtruar fene. Asnje dege shkencore (biologjia, kimia, fizika etj.) nuk eshte shpikur per nje qellim te tille. Shkenca eshte nje disipline, e cila perdoret per shpjeguar shkaqet e fenomeneve natyrore ne bote. Kete disipline e cila ka kete qellim, nese e perdorni per te vertetuar ose pergenjeshtruar fene, eshte perdorim i gabuar. Nese shkenca perdoret per te shpjeguar dicka fetare, pro ose kunder, eshte perdorim i gabuar dhe ne kete rast demton me shume fene. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 182-199

11	<p>Problemet aktuale të relatës fe-shkencë Ne gjykimet shkencore, nuk duhet të kene rol mendimet personale, ndjenjat etj. pasi veprimtaria shkencore nuk është personale. Nuk duhet të ngaterrohen konkluzionet shkencore ne momentin e transferimit ne jeten e perditshme. Megjithese shkenca ka ndikuar ne shume fusha te jetes, te shprehja “pikepamje shkencore”, fjala “shkencore” është term qe e tejkalon shkencen. Se dyti, shkenca meret me pergjithesime. Shkencetari kryen vezhgime, eksperimente, mbledh prova dhe perpiqet te mos anashkaloje asgje. Mirepo ato i konsideron si “reflektim nje nga nje te se pergjithshmes”. Dicka qe ndodh vetem nje here, nuk hyn ne fushen e shkences. Psh. Mrekullite e profeteve. Pohimet fetare, nuk mund te vertetohen ose te pergenjeshetrohen me kriteret shkencore, nuk është nevoja per to. Kete na e tregon me se miri Filozofia e Gjuhes. Pohimet fetare jane qendrimet propozicionale. Per shkak se nuk dallojne dot nje pohim/propozicion, nga nje qendrim propozicional, duket sikur pohimet fetare, mund te vertetohen me shkencen dhe logjiken. C’është Propozicioni dhe Qendrim propozicional? Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 200-213</p>
12	<p>Pluralizmi fetar Ka dallime të konsiderueshme midis teologëve që i përkasin të njëjtit “kamp” ose feje dhe shumë veçori mbivendosjeje midis qasjeve të ndryshme. 1. Eksklusivizëm: vetëm ata që dëgjojnë ungjillin të proklamuar dhe pranojnë në mënyrë eksplicite Islamin/Krishërimit, janë të shpëtuar.; 2. Inkluzivizëm: Islami/Krishërimi është revelata normative e Zotit, ndonëse shpëtimi është i mundur edhe jashtë këtij besimi, por ky shpëtim vjen gjithnjë prej këtij besimi.; 3. Pluralizëm: të gjitha fetë janë rrugë të barabarta dhe të vlefshme drejt realitetit të vetëm hyjnor dhe Islami/Krishërimi është një revelatë midis shumë revelatave të tjera njësoj të barabarta dhe të vlefshme.; Filozofi i fesë, me origjinë angleze, John Hick, ka zhvilluar një pozicion pluralist kryesisht duke u angazhuar në dialog me filozofinë perëndimore dhe fetë botërore. Do të ishte instruktuese të shihnim më në detaj tezën e Hick-ut, i cili kombinon shumë prej theksimeve në qasjet e lartpërmendura pluraliste. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 221-250</p>
13	<p>Lidhja fe-moral A mund të jete nje njeri i moralshem pa qene fetar? Ku e ka bazen morali? Te feja apo te ndergjegja? Në shekullin aktual disa njerëz, duke marrë parasysh përparimin mendor, pretendojnë në atë se feja nuk është e nevojshme, por bile as morali, edhe pse është vërtetuar se një shoqëri nuk mund të jetojë pa moral. Këta themelet e moralit tentojnë t’ia ngarkojnë ndërgjegjes, dhe kështu, të mos ketë nevojë për fe. Ja disa qasje ne lidhjen fe-moral: 1. Feja është e demshme per moralin. 2. Feja nuk ka lidhje me moralin. 3. Feja është e dobishme per moralin. 4. Feja është e domosdoshme per moralin. Kanti e con me tej kete mendim duke nxjerre edhe Zotin si postulat te ekzistences se moralit. Pa Zotin morali nuk mund te ekzistoje. Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 214-220</p>
14	<p>Jeta pas vdekjes Edhe pse vdekja është një pjesë e jetës po aq sa jeta, njerëzit në përgjithësi priren të mendojnë se jeta është e mirë dhe vdekja është e keqe. Madje mund të thuhet se pak gjëra i bëjnë njerëzit të mendojnë aq thellë sa vdekja: A është vdekja një zhdukje? A ka jetë pas vdekjes?Vdekja është përmendur në filozofi, veçanërisht aty ku dëshirohet të shprehet kuptimi dhe rëndësia e jetës. Mendimet dhe besimet rreth vdekjes kishin një pjesë të madhe në formimin e botëkuptimeve optimiste dhe pesimiste. Disa e panë vdekjen si një katastrofë që i dha fund çdo suksesi në jetë: Gjatë historisë, numri i atyre që thanë "Meqenëse ka vdekje, atëherë asgjë nuk ka një kuptim dhe vlerë në pikën e fundit" nuk ka qenë i paktë. Nga ana tjetër, sipas disave, jeta fiton kuptimin dhe vlerën e saj të vërtetë vetëm përmes vdekjes. Njeriu është një qenie e vdekshme. A e frikëson kjo situatë? Nëse përgjigja për këtë pyetje do të ishte pozitive, fjalët e shprehura për të kapërcyer frikën e vdekjes nuk do të kishin kuptim dhe vlerë. Pse njerëzit, ose shumica e njerëzve, kanë frikë nga vdekja? 1. Besimi në pavdekësi; 2. Themelet e Besimit të Pavdekësisë.; 3. Çështja e formes së jetës pas vdekjes dhe kritika e Gazaliut ndaj filozofëve mbi "Ringjalljen e trupave" Cafer Sadik Yaran, Din Felsefisine Giriş, Dem Yay., İstanbul, 2012 fq. 251-271</p>
15	Përsëritje e lëndës
16	Provim Final
	<b>Parakushtet</b>
	<p style="text-align: center;"><b>Literatura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Din Felsefisine Giriş, Cafer Sadik Yaran, Dem Yay., İstanbul, 2012</li> </ul>
	<p style="text-align: center;"><b>Referenca të tjera</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Din Felsefesi, Prof. Dr. Mehmet S. Aydın, Selçuk Yayınları, Ankara: 1992.</li> </ul>
	<b>Punë laborator</b>
	<b>Përdorimi i komp.</b>
	<b>Të tjera</b>
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>	
1	Studentët do të mësojnë termat themelore të filozofisë së fesë.

<b>2</b>	Studentët do të përfitojnë njohuri rreth problemeve kryesore të filozofisë së fesë.
<b>3</b>	Studentët do të përftojnë aftësinë për të interpretuar çështjet dhe problemet kryesore të filozofisë së fese.

### Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	30
Kuize	0	0
Projekte	1	20
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
<b>Total</b>		100

### Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	7	98
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>150</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>6</b>
<b>ECTS</b>			<b>6</b>